



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC PE KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njesia.org. Org.Jedinitca Org.Unit	SP-02
Nr.i Faqeve Br. Stranica No.Pages	05
Nr.i Prot. Broj Prot. Prot. No.	339-2/25
Data: Datum: Date	13.05.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	10.04.2025
REFERENC-Ë:	25/339/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Hib Petrol" Sh.p.k. Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 25/339//DMMU dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Hib Petrol" Sh.p.k. Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj – për stacionin e karburanteve, Prizren.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Kompania "Hib Petrol" Sh.p.k. Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj – pajiset me Pëlqim Mjedisor për veprimtarinë: stacion i karburanteve në ngastrën kadastrale me Nr. P-71813068-11561-3 në ZK Prizren, komuna e Prizrenit, me kapacitet të rezervuarëve për naftë $V_1= 21172$ litra, $V_2= 38997$ litra, rezervuari për benzinë me kapacitet $V_1=20267$ litra, $V_2=10064$ litra, nën kushtet si vijon:

- Të ndërtohet sistemi për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave sipërfaqësore, nga të gjitha sipërfaqet funksionale dhe ujërave të zeza (seperator për vajra dhe gropa septike) adekuate me standarde dhe konform ligjit;

Faqe 2 nga 5

- Të betonohet dhe izolohej platoja ku janë të vendosur rezervuarët e naftës, benzinës dhe gazit të lëngëzuar naftor (GLN);
- Rezervuarët e karburanteve të naftës, benzinës dhe gazit të lëngëzuar naftor (GLN) të rrethohen me mur statik prej betoni të armiruar.
- Të betonohet dhe izolohej platoja e sipërfaqeve operationale;
- Të bëhet vendosja e kontejnerëve të posaçëm për hedhjen e mbeturinave të ngurta në mënyrë që ambienti rreth lokalitetit të jetë çdo herë i pastër;
- Rregullisht të pastrohet seperatori dhe gropa septike;
- Të bëhet monitorimi i ujit para shkarkimit të tij;
- Të bëhet mbjellja me drunjëve dekorativ dhe barishte e sipërfaqeve të pa gjelbëruara;
- Të përgatitet dhe implementohet plani aksional për raste aksidenti;
- Bazuar në Ligjin e Ujërave Nr.04/L-147, neni 48, pika 1 dhe 1.3, me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujë rrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar: ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujë rrjedhave dhe akumulimeve.
- Ndalohet veprimtaria e kompanisë "Hib Petrol" Sh.p.k. Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj – për stacionin e karburanteve në Prizren në largësi jo më pak se tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.
- Të bëhet plani për masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit, gjatë zbatimit të projektit si dhe pas përfundimit të tij;
- Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk respektohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të merret (revokohet).

Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar, nga Kompania "Hib Petrol" Sh.p.k. Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj – për stacionin e karburanteve në ngastrën kadastrale me Nr. P-71813068-11561-3 në ZK Prizren, komuna e Prizrenit me kapacitet të rezervuarëve për naftë $V_1 = 21172$ litra, $V_2 = 38997$ litra, rezervuari për benzinë me kapacitet $V_1 = 20267$ litra, $V_2 = 10064$ litra, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me rekomandim të Komisionit për VNM, nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqim Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181.

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit për VNM 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimt e të njejt.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 25/339/1 - ZSP/ /25 datë: 10.04.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Komunës së Prizrenit
6. Divizionit për komunikim me publikun
7. Arkivit të MMPHI



U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të
MMPHI

2. SHTOJÇË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1.Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2.Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithsesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.